

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË KORÇË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Korçë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri më 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 122, datë 30.09.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 453/9, datë 30.9.2014, i ka rekomanduar z. Sotiraq Filo, Kryetar i Bashkisë Korçë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetjet nga auditimi: Nuk kanë gjetur zbatim të plotë rekomandimet e e Kontrollit të Lartë të Shtetit, të dërguara me shkresën nr. 575/10, prot, datë 30.09.2012, - Masa për shpërblim dëmi, të cilat janë në proces gjyqësor.

Rekomandimi: Bashkia Korçë të marrë masa për ndjekjen në të gjitha shkallët e gjyqësorit rekomandimet për shpërblim dëmi të dërguara me shkresën nr. 575/10, prot, datë 30.09.2012, të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilat janë në proces gjyqësor, *trajtuar hollësisht në Aktverifikimin nr. 01, datë 13.06.2014 dhe pikën nr.1, faqe 11-23 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.*

Në vijimësi

2. Gjetjet nga auditimi: Nuk është implementuar plotësisht ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pasi;

- numri i punonjësve që ka aktualisht Bashkia Korçë, është tepër i lartë krahasuar me të ardhurat e veta dhe mundësitë financiare të bashkisë.

- ende është në fuqi Rregullorja e brendshme e funksionimit të administratës së Bashkisë e miratuar që në vitin 2008, duke mos e rishikuar dhe pasuruar edhe me elementë të rinj, nga ligji “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- ende nuk është miratuar strategjia e riskut dhe nuk është hapur regjistri i tij, duke mos evidentuar parregullsitë dhe masat e marra për parandalimin e mashtrimit.

Rekomandimi: Bashkia Korçë, të marrë masa për implementimin e kërkesave të ligjit Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, në këto fusha:

- rishikimin e strukturës organizative, me synim reduktimin e numrit të punonjësve në përputhje me mundësitë financiare të bashkisë.

- miratimin e strategjisë së riskut dhe të hapë regjistrin e tij, ku të evidentohen parregullsitë dhe masat e marra për parandalimin e mashtrimit.

- miratimin e rregullores së brendshme të funksionimit të administratës së Bashkisë.

Në vijimësi

3. Gjetjet nga auditimi : Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka ushtruar kontroll dhe nuk është evidentuar gjendja e debitorëve për abonentët familjarë. Pasi për asnjë vit nuk është kryer rakordimi me Ujësjellës Sha, Korçë, në lidhje me evidentimin e numrit të abonentëve dhe vlerat përkatëse, për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit. Për pasojë abonentët familjarë të cilët nuk kanë paguar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, nuk janë vënë në dijeni për detyrimin e papaguar dhe nuk u është dërguar zyrtarisht njoftim vlerësimi tatimor, në zbatim të nenit 70, pika 3, të ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore”.

Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Sektori i Auditit të Brendshëm të Bashkisë Korçë, të rakordojnë me Ujësjetës Shë, Korçë duke evidencuar abonentët familjarë të cilët nuk kanë paguar detyrimet, për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit. Të hartohen listat për secilin Rajon (Njësi administrative) dhe për secilin abonent familjarë debitorë të dërgohen zyrtarisht njoftim vlerësimi tatimor.

Deri më datën 15.12.2014

4. Gjetjet nga auditimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore edhe pse në disa raste subjekteve debitorë u ka dërguar urdhër bllokimit në Banke, ku nga kjo e fundit nuk është vepruar me arsyetimin e mungesës së gjendjes financiare apo mungesës të hapjes llogarisë bankare. Ndërkohë, për mos pagesën e taksave dhe tarifave vendore, nga subjektet e biznesit të vogël, nga administrata tatimore e Bashkisë Korçë, nuk është kërkuar marrja e masave administrative gjombë në masën 25% të detyrimit, apo deri në kallëzim penal, siç parashikohet në nenet 114 dhe 131 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar.

Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore dhe përmbartimore për arkëtimin e detyrimeve nga subjektet e biznesit të vogël, të klasifikuara sipas llojit dhe vlerës të detyrimit, të cilat ndodhen në Drejtorinë e Taksave të Bashkisë Korçë.

Në rast se subjektet edhe pas dërgimit të Urdhër bllokimeve në Banke dhe njoftimeve zyrtare, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, pasi tu vendosen masa administrative (gjombë në masën 25% të detyrimit sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008), të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodit Penal të R.SH, neni 181, “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

Deri më datën 30.11.2014

5. Gjetjet nga auditimi: Bashkia Korçë, ka kryer financime Projektesh të Përbashkëta me Fondacionet, pa zhvilluar procedura prokurimi, por duke u mjaftuar vetëm me miratimin e fondeve në Këshillin Bashkiak dhe kontratave të lidhura ndërmjet dy palëve. Paga këto në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 4, “Fusha e zbatimit” ku përcaktohet se: Ky ligj zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit publik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 5,6,7,8 e 9 të këtij ligji që rregullohen me ligj tjetër.

-Për rastet e programeve a të reklamave, për transmetimin nga Operatorët Radiotelevizivë ose botim në median e shkruar dhe për kontratat, për kohë transmetimi nga organet e administratës shtetërore, pagesat e operatorëve privatë të kryera nga Bashkia Korçë, janë në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikat 7, 8 dhe 9 të VKM nr.1195, datë 05.08.2008.

-Për rastet e organizimit të ngjarjeve kulturore, artistike, pagesat e operatorëve privatë të kryera nga Bashkia Korçë, janë në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikat 3,4,5,6,7, 8 dhe 9 të VKM nr. 1173, datë 06.01.2009.

Rekomandimi: Bashkia Korçë në se do të kryejë financime Projektesh të Përbashkëta me Fondacionet, për rastet e programeve a të reklamave, për transmetimin nga Operatorët Radiotelevizivë ose botim në median e shkruar dhe për kontratat për kohë transmetimi, të ngjarjeve kulturore, artistike, të zbatohen kërkesat e përcaktuara në dispozitat ligjore të cituara më sipër.

Në vijimësi

6. Gjetjet nga auditimi: Për marrjen në dorëzim të punimeve të ndërtimit, shërbimeve të kryera dhe marrjes së mallrave e materialeve në dorëzim, nuk është ngritur komision me urdhër të veçantë të titullarit, me të paktën 3 specialistë të fushës, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Rekomandimi: Për të gjitha furnizimet dhe marrjen në dorëzim të punimeve të ndërtimit, shërbimeve të kryera dhe marrjes së mallrave e materialeve, Bashkia Korçë me urdhër të veçantë, të titullarit të ngrëjë një komision, me të paktën 3 specialistë të fushës.

Në vijimësi

7. Gjetjet nga auditimi: Është konstatuar se nga Drejtoria e Taksave, Policisë Bashkiake dhe Drejtorisë Juridike, nuk janë propozuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak paketa me llojet dhe

masën e gjobës për çdo shkelje, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative., mos veprime këto në kundërshtim me kërkesat e nenit 6 “Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative” të ligjit nr.10.279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Rekomandimi: Drejtoria e Taksave, Policia Bashkiake dhe Drejtoria Juridike, të marrë masa për të paraqitur, propozuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak, paketën me llojet dhe masën e gjobës për çdo shkelje, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative.

Në mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak

8.Gjetjet nga auditimi: Policia Bashkiake nuk ka marrë masa për arkëtimin e 19 gjobave të prapambetura, **në vlerën 33,000 lekë**, duke mos zbatuar nenin 14 pika 2 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar dhe nenet, 9, 22 dhe 30 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Rekomandimi: Policia Bashkiake të marrë masa për arkëtimin e gjobave të prapambetura, në të kundërtën të fillojnë ndalesat ndaj personave të cilët i kanë vendosur dhe nuk i kanë arkëtuar këto gjoba në vlerën 33,000 lekë.

Brenda datës 31.12.2014

9.Gjetjet nga auditimi: Nga auditimi rezulton se në Inventarin e Bashkisë Korçë, figurojnë gjendje mjete dhe pajisje të cilat nuk kanë vlerë përdorimi apo janë pa efektivitet dhe për këto nuk është përgatitur dokumentacioni për nxjerrjen jashtë përdorimit, duke mos zbatuar kriteret dhe procedurat e përcaktuara në pikat 95-119 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Rekomandimi: Bashkia Korçë të marrë masa për nxjerrjen jashtë përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve që figurojnë gjendje, të cilat nuk janë me efektivitet dhe kanë plotësuar afatin e përdorimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore.

Brenda datës 30.12.2014

10.Gjetjet nga auditimi: Sektori i Regjistrimit të Pronave Publike, nuk ka marrë masa dhe nuk ka janë dërguar për regjistrim në ZVRPP Korçë, pasuri të bashkisë si: truall, objekte ndërtimi, sheshe, lulishte, rrugë, vendstrehime, buste etj, si dhe nuk janë përfshirë në inventarin kontabël pasuror të Bashkisë, në zbatim të nenin 7, të ligjit nr. 9228, datë 29.04. 2004, “Për kontabilitetin dhe për pasqyrat financiare”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe kreu IV, pika 74, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Rekomandimi: Sektori i Regjistrimit të Pronave Publike, të marrë masa dhe të dërgojë për regjistrim në ZVRPP Korçë, pasuritë e Bashkisë, truall, objekte ndërtimi, sheshe, lulishte, rrugë, vendstrehime, buste etj, si dhe të kryejnë regjistrimet për pasqyrimin e tyre në evidencën kontabile të Bashkisë Korçë.

Brenda datës 31.12. 2014

11.Gjetjet nga auditimi: Drejtoria Juridike në Bashkinë Korçë, për truallin e dhënë me qira mbi sipërfaqen 200 m², nuk ka zhvilluar procedura konkurrimi dhe nuk ka plotësuar dokumentacionin e përcaktuar në kapitullin e II, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011” Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar”.

Rekomandimi: Drejtoria Juridike në Bashkinë Korçë, për truallin me sipërfaqe 200 m² që do të jepet me qera, të zhvillojë procedura konkurrimi dhe ta plotësojë me dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuara në VKM të cituar më sipër.

Të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore prishjen e kontratave të lidhura me subjekte private për truallin e dhënë me qira deri në 200 m², pasi lidhja e këtyre kontratave është bërë në kundërshtim me paragrafin e dytë të shkronjës “a”, pika 6, kreu I, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011.

Brenda 30.11. 2014

12.Gjetjet nga auditimi: Dosjet teknike, që u janë dërguar nga subjektet e ndërtimit në zyrat e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik, janë pranuar pa u protokolluar dhe shoqëruar me listën e përmbajtjes së dokumentacionit. Ndërkohë nuk është kryer Inventarizimi i dosjeve për gjithë

periudhën, të cilat janë gjendje në zyrat e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor dhe nuk janë dorzuar në zyrën e arkivit, siç, përcaktohet në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe rregulloren e nxjerrë për zbatimin e tij.

Rekomandimi: Nga INUV Korçë, të meren masa që dosjet teknike të cilat dërgohen nga subjektet e ndërtimit, të mos pranohen pa u protokolluar dhe shoqëruar me listën e përmbajtjes së dokumentacionit. Ndërkohë të kryhet inventarizimi i dosjeve të punës së INUV, për gjithë periudhën, të cilat janë gjendje dhe nuk janë dorzuar në zyrën e arkivit.

Brenda 30.11. 2014

13. Gjetjet nga auditimi: Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik në Bashkinë Korçë, nuk ka marrë masa, për prishjen e 5 ndërtimeve pa leje ndërtimi, në zbatim të paragrafit të fundit të nenit 13, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar.

Rekomandimi: Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Vendor në Bashkinë Korçë, të marrë masa organizative, administrative dhe ligjore për prishjen e 5 ndërtimeve pa leje ndërtimi të evidentuara.

Brenda 30.11. 2014

14. Gjetjet nga auditimi: Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Vendor në Bashkinë Korçë, nuk ka marrë masa dhe nuk ka kallëzuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, 12 subjekte që kanë ndërtuar pa leje ndërtimi, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 5, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar.

Rekomandimi: Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Vendor në Bashkinë Korçë, të marrë masa e të kallëzojë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, 12 subjekte që kanë ndërtuar pa leje ndërtimi.

Brenda 30.11. 2014

15. Gjetjet nga auditimi: Inspektorati Ndërtimor Urbanistik dhe Drejtoria Juridike nuk kanë marrë masa dhe nuk kanë kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e gjobave në shumën **1,830,000 lekë**. Në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve” dhe pikës 16 të VKM nr. 862, datë 5.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai vendor” (Ndryshuar me VKM nr. 625, datë 28.7.2010).

Rekomandimi: Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor i Bashkisë Korçë, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore, administrative dhe përmbartimore arkëtimin e 12 gjobave në shumën **1 830 000 lekë**.

Brenda 30.11. 2014

16. Gjetjet nga auditimi: Meqenëse një pjesë e aksioneve të Ujësjiellës sh.a, Korçë i ka kaluar Bashkisë, nuk është caktuar për arkëtimin dhe mbledhjen e disa taksave dhe tarifave nga popullata, së bashku me faturat e ujit të pijshëm. Bazuar kjo në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, -Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, këshilli i bashkisë ose i komunës, sipas shkronjës ii) -përcakton mënyrën e mbledhjes së taksës, përfshirë zgjedhjen e agentit fiskal dhe detyrimet e ndërsjella.

Rekomandimet: Bashkia Korçë, të marrë masa që për mbledhjen e arkëtimin e taksave dhe tarifave nga popullata, të caktojë si agent tatimor Ujësjiellës sh.a, Korçë dhe për realizimin e saj të përgatitet aktmarrëveshja e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak, si dhe të kryejë rakordimet periodike mujore, tremujore e vjetore, duke shmangur rrugët abuzive.

Në mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak

17. Gjetjet nga auditimi: Nga auditimi rezulton se nëpërmjet Bashkisë Korçë dhe Fondacioneve “K.” dhe “M.E.” janë kryer financime Projektsh të Përbashkëta, bazuar ndërmjet kontratave të lidhura dhe miratimit të fondeve në Këshillin Bashkiak, duke mos përgatitur e administruar dokumentacionin e plotë ligjor e fiskal, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar.

Rekomandimi: Bashkia Korçë, t’i kërkojë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Korçë, ushtrimin e një auditimi për periudhën që nga fillimi i

bashkëpunimit me këtë Bashki, në lidhje me dokumentimin e veprimtarisë dhe pagesën detyrimeve fiskale nga Fondacionet “K...” dhe “M.E”.

Deri më datën 30.11.2014

B.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe (Nëpunësi zbatues), të kryejë kontabilizimet duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe procedurat përmbartimore me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **në vlerën 3,606,297 lekë, si më poshtë;**

1.Gjetjet nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, të kontratës së blerjes së karburantit datë 14.08.2012 dhe datë 13.05.2013, rezultojnë diferenca në çmimin e zbatuar duke përfitim më tepër, nga Shoqëria “J.D.” sh.p.k. në **vlerën 125,589 lekë.**

Rekomandimi: Bashkia Korçë të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e **vlerës 125,589 lekë**, e cila përfaqëson diferencën e çmimit të zbatuar dhe përfituar më tepër nga Shoqëria “J.D.” sh.p.k.

Brenda datës 30.11.2014

2. Gjetjet nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, të kontratës së blerjes së karburantit të kontratës datë 14.08.2012 dhe datë 13.05.2013, rezultojnë diferenca në çmimin e zbatuar dhe përfitim më tepër nga Shoqëria “P...” sh.p.k. në **vlerën 912,614 lekë.**

Rekomandimi: Bashkia Korçë të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e **vlerës 912,614 lekë**, e cila përfaqëson diferencën e çmimit të zbatuar dhe përfituar më tepër nga Shoqëria “P...” sh.p.k.

Brenda datës 30.11.2014

3.Nga auditimi rezulton se 6 punonjës të Bashkisë Korçë, të cituar më poshtë kanë përfituar më tepër pagë në vlerën 322,906 lekë, në kundërshtim me lidhjen nr. 4 “Klasifikimi i funksioneve të vendeve të punës për nëpunësit civil të bashkive dhe qarqeve dhe të nëpunësve të komunave të përcaktuar në VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve e grupimin e njësive të qeverisjes vendore dhe caktimin e kufijve të pagave të organeve të qeverisjes vendore”. Pasi ata nga klasifikimi në kategorinë II-b , duhej të klasifikoheshin në kategorinë III-a/1, të lidhjes nr. 2 “Nivelet e pagave për nëpunësit civil në bashkitë të tjera, njësitë bashkiake të Tiranës dhe nëpunësit e bashkive e komunave”, kolona 5-të, njësitë e qeverisjes vendore me 50001-100000 banorë.

Rekomandimi: Bashkia Korçë të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e **vlerës 322,906 lekë, sa përfituar tepër nga 6 punonjësit si më poshtë:**

- vlera 52,144 lekë nga **z. A.Q.** me detyrë ish-Kryeinspektor i Inspektoratit të Ndërtimit, nga të cilat 39,486 lekë për vitin 2012 dhe 12,658 lekë për vitin 2013;

- vlera 29,012 lekë nga **z. I.L.** me detyrë Kryeinspektor i Inspektoratit të Ndërtimit, nga të cilat 20,169 lekë për vitin 2013 dhe 8,843 lekë për vitin 2014;

- vlera 83,245 lekë nga **znj. I.G.** me detyrë Administratori i Rajonit nr. 1, nga të cilat në vitin 2012 ka përfituar tepër shumë 40,766 lekë, në vitin 2013 shumë 32,120 lekë dhe në vitin 2014 shumë 10,359 lekë;

- vlera 22,377 lekë nga **z. H.P.** me detyrë Administratori i Rajonit nr. 2, e përfituar tepër për periudhën janar – qershor të vitit 2012;

- vlera 52,881 lekë nga **z. A.L.** me detyrë Administratori i Rajonit nr. 2, nga të cilat në vitin 2012 ka përfituar tepër shumë 20,761 lekë dhe në vitin 2013 shumë 32,120 lekë;

- vlera 83,247 lekë nga z. E.M. me detyrë Administratori i Rajonit nr. 3, nga të cilat në vitin 2012 ka përfituar tepër shumën 40,767 lekë, në vitin 2013 shumën 32,120 lekë dhe në vitin 2014 shumën 10,360 lekë.

Brenda datës 30.03. 2015

4.Gjetjet nga auditimi: Nga auditimi rezulton se janë paguar për punime të pakryera në objektet e mëposhtme nga pika 4.1 deri 4.7, në vlerën prej **1,874,646 lekë**, respektivisht:

4.1.Në vlerën 329,932 lekë (pa t.v.sh), nga bashkimi i operatorëve ekonomik “N...” sh.p.k, & “K...” sh.a, pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit me objekt “Rikonstruksion i Sheshit para Katedrales”, rezultojnë diferenca në volume punimesh të pakryera dhe përfitim më tepër, në kundërshtim me preventivin e ofertës paraqitur në tender dhe kontratën e zbatimit të punimeve datë 21.05.2012.

4.2. Në vlerën 160.200 lekë (pa t.v.sh), nga bashkimi i operatorëve ekonomik “S...” sh.p.k, & “B...” sh.p.k, pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit me objekt “Sistemim asfaltim, Blloku i banimit lagja nr. 17”, rezultojnë diferenca në volume punimesh të pakryera dhe përfitim më tepër, në kundërshtim me preventivin e ofertës paraqitur në tender dhe kontratën e zbatimit të punimeve datë 16.08.2010.

4.3.Në vlerën 395,510 lekë (pa t.v.sh), nga operatori ekonomik “J... C...” shpk, të rezultuara nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit, ku rezultojnë diferenca në volume punimesh të pakryera dhe përfitim më tepër, në kundërshtim me preventivin e ofertës paraqitur në tender dhe kontratën e zbatimit të punimeve datë 26.11.2011, të cilat duhet të arkëtohen, që i përkasin 3 objekteve, si më poshtë:

- 109.480 lekë (pa t.v.sh) për punimet me objekt “Sistemim asfaltim, Blloku i banimit lagja nr. 15”.

- 127.050 lekë (pa t.v.sh), për punimet me objekt “Sistemim asfaltim, Blloku i banimit lagja nr. 15 (vazhdim)”

- 158.980 lekë (pa t.v.sh) për punimet me objekt “Sistemim asfaltim, Blloku i banimit lagja nr. 17/1”

4.4.Në vlerën 386,801 lekë nga operatori ekonomik “V...” shpk, pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit, që i përkasin 2 objekteve;

-266.333 lekë (pa t.v.sh), për punime të pakryera me objekt “Sistemim asfaltim, Blloku i banimit lagja nr. 15”, kontratën e zbatimit të punimeve datë 26.11.2011.

- 120.468 lekë (pa t.v.sh), për punime të pakryera me objekt “Sistemim asfaltim rruge ne blloqet e pallateve , lagja nr. 17/1” kontratën e zbatimit të punimeve datë 13.12.2011.

4.5.Në vlerën 89.600 lekë (pa t.v.sh), nga operatori ekonomik “A...” shpk, pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit me objekt “Sistemim asfaltim, Blloku i banimit lagja nr. 15 (vazhdim)”, rezultojnë diferenca në volume punimesh të pakryera dhe përfitim më tepër, në kundërshtim me preventivin e ofertës paraqitur në tender dhe kontratën e zbatimit të punimeve datë 21.05.2012.

4.6.Në vlerën 432.443 lekë (pa t.v.sh), nga operatori ekonomik “K...” sh.p.k, pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të kryerjes së shërbimit të pastrimit dhe situacionet e paraqitura për pagesë për çdo muaj, rezulton se janë pasqyruar në situacione volume në 17 zëra shërbimesh të pakryera dhe përfitim më tepër, në kundërshtim me preventivin e ofertës paraqitur në tender dhe kontratën e zbatimit të punimeve datë 29.02.2012.

4.7.Në vlerën 80,160 lekë (pa t.v.sh), nga bashkimi i shoqërive “L...” sh.p.k, & “E...” sh.p.k përfaqësuar me prokurë të posaçme nga shoqëria “L...” sh.p.k, pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit me objekt “Meremetimi i shkollave”, rezultojnë diferenca në volume punimesh të pakryera dhe përfitim më tepër, në kundërshtim me preventivin e ofertës paraqitur në tender dhe kontratën e zbatimit të punimeve datë 12.07.2013.

Rekomandimi: Bashkia Korçë të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore ndaj 7 operatorëve ekonomik të poshtë shënuar, shpërblimin e dëmit në **vlerën 1,874,646 lekë, pasi** nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit rezultojnë diferenca në volume punimesh të pakryera sipas kontratave të zbatimit të punimeve, respektivisht:

1. Në **vlerën 329,932 lekë**, nga bashkimi i operatorëve ekonomik “N...” sh.p.k, & “K...” sh.a. sipas kontratës të zbatimit të punimeve datë 21.05.2012.
2. Në **vlerën 160.200 lekë**, nga bashkimi i operatorëve ekonomik “S...” sh.p.k, & “B...” sh.p.k, sipas kontratës të zbatimit të punimeve datë 16.08.2010.
3. Në **vlerën 395,510 lekë**, nga operatori ekonomik “J...C...” shpk, sipas kontratës zbatimit të punimeve datë 26.11.2011.
4. Në **vlerën 386,801 lekë**, nga operatori ekonomik “V...” shpk. sipas kontratës të zbatimit të punimeve datë 16.08.2010.
5. Në **vlerën 89.600 lekë**, nga operatori ekonomik “A...” shpk. sipas kontratës të zbatimit të punimeve datë 21.05.2012.
6. Në **vlerën 432.443 lekë**, nga operatori ekonomik “K...” shpk. sipas kontratës të zbatimit të punimeve datë 29.02.2012.
7. Në **vlerën 80,160 lekë**, nga bashkimi i shoqërive “L...” sh.p.k, & “E...” sh.p. sipas kontratës të zbatimit të punimeve datë 12.07.2013.

Brenda datës 31.12. 2014

Gjetjet nga auditimi: Nga auditimi rezulton se K.K., me detyrë përgjegjësi i ligjshmërisë në Drejtorinë Juridike është paguar në **vlerën 3,000 lekë**, për udhëtim e dieta ,për datën 19.02.2012-20.02.2012 fjetje tek Hotel Kalaja,Tiranë, me tvsh, Fatura tatimore me nr. Serie 86609514 pa numër datë 20.02.2012, pasi si data dhe shifrat në faturë janë me korrigjim. Pagesë kjo në kundërshtim me pikën 36 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Rekomandimi: Bashkia Korçë të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit në vlerën **3,000 lekë**, ndaj K.K., me detyrë përgjegjësi i ligjshmërisë në Drejtorinë Juridike.

Brenda datës 31.12. 2014

Gjetjet nga auditimi: Nga auditimi rezulton se me urdhër shpenzimin nr.207, datë 08.05.2013, u janë paguar në **vlerën 367,542 lekë**, 31 personave pjesëmarrës në pritje përcjelljen e organizuar për hartimin e planit restaurimit të pazarit të vjetër të Korçës si dhe u janë përballuar shpenzimet për fjetje në Hotel dhe ushqimi për 3 ditë, 31 personave respektivisht; 10 studentëve francezë dhe 29 shqiptarëve. Kjo pagesë është kryer në mungesë të ftesës, listës me personat pjesëmarrës, programit të miratuar nga Këshilli Bashkiak, në kundërshtim me pikën 7 të VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për shpenzimet për pritje, përcjellje dhe trajtimi që u bëhet delegacioneve të huaja”. Ekziston një listë e pjesëmarrësve e pakuptueshme dhe e pa konfirmuar nga pjesëmarrësit, ndërkohë si ushqimi dhe fjetja është përfshirë në një faturë dhe nuk përcaktohet veças, për efekt krahasimi me procedurat dhe kuotat e përcaktuara në VKM nr. 243, datë 15.05.1995.

Rekomandimi: Bashkia Korçë të analizojë dhe në mungesë të një dokumentacioni të plotë, të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit në vlerën **367,542 lekë**, ndaj personave pjesëmarrës në pritje përcjelljen e organizuar për hartimin e planit të restaurimit të pazarit të vjetër të Korçës.

Brenda datës 31.03. 2015

C.MASA DISIPLINORE

c.1.Në zbatim të ligjit nr. 152/2013, miratuar më datën 30.05.2013 ”Për Nëpunësin Civil” dhe akteve nënligjore të dalë në zbatim të tij, rekomandojmë që të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore ndaj 13 punonjësve si më poshtë:

1.K.K., aktualisht Drejtor i kontrollit të ardhurave dhe territorit, ish-Përgjegjës i Sektorit të Regjistrimit të Pasurisë, i ngarkuar me detyrën e Drejtorit të Financës, për periudhën 6 mujore, emëruar me urdhrin nr. 44 datë 20.05.2013 deri më datë 25.11.2013, **pasi;**

-Për dorëzimin e mallrave të ndihmave të dhuruara nga Bashkia Korçë të tërhequra kundrejt nënshkrimit në fletë daljet përkatëse, për fatkeqësinë natyrore të bllokimit nga dëbora, në 2 Komunitat Vithkuq-Korçë dhe Rajcë-Përrenjas, pa u pajisur me dokumentacion për dorëzimin e vlerës prej 345,690 lekë, si, listat e personave që janë furnizuar me ndihma po kështu edhe konfirmim nga përfaqësuesit e Komunitës, disa artikujt ushqimorë si, vaj, sheqer, oriz, vaj, etj, respektivisht me;

-Fletë daljen nr. 76, datë 15.02.2012, në vlerën 295,190 lekë, firmosur nga tërheqësi i mallit Kliton Kita.

-Fletë daljen nr. 80, datë 21.02.2012, në vlerën 50,500 lekë, firmosur nga tërheqësi i mallit, Fatura nr. 76, datë 21.02.2012.

-Për marjen në dorëzim të tyre nuk ishin hartuar procesverbalet, në kundërshtim me pikat: 42, 43, 52 dhe 54 "Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara" dhe të udhëzimit të Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

-Për shkeljet e kryera në moszbatimin e shkronjës "b" e "c", pika 7, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.

2.I.J., specialiste e kontabilitetit të magazinave dhe të të ardhurave, *pasi*:

-Nga mos kontrolli ka kryer kontabilizimin e veprimeve duke lejuar që të bëhen hyrje materiale pa u pajisur me proces verbal dorëzim të mallrave për 161 raste për blerjet në vlera të vogla, në vlerën 12,886,873 lekë, respektivisht: Për vitin 2012- 106 raste me vlerë 8.504.675 lekë dhe vitin 2013 në 55 raste në vlerën 4,382,198 lekë.

-Ka lejuar dhe kryer kontabilizimin e veprimeve për dorëzimin e mallrave ushqimore (ndihmave) për fatkeqësinë natyrore të bllokimit nga dëbora, të dhuruara nga Bashkia Korçë, në 2 Komunitat Vithkuq-Korçë dhe Rajcë-Përrenjas, në mungesë të dokumentacionit si, listat e personave që janë furnizuar me ndihma po kështu edhe konfirmim nga përfaqësuesit e Komunitës për dorëzimin e vlerës prej 345,690 lekë, respektivisht Fletë dalja nr. 76, datë 15.02.2012, në vlerën 295,190 lekë dhe Fletë dalja nr. 80, datë 21.02.2012, për vlerën 50,500 lekë.

Veprime apo mosveprime për mos hartimin e procesverbaleve në lidhje me marjen në dorëzim të mallrave dhe materialeve, në kundërshtim me pikat 42, 43, 52 dhe 54 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

3.A.Sh., me detyrë përgjegjëse, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Planifikimit Strategjik dhe Kordinimit me Donatorët.

4.E.K., me detyrë specialiste në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Planifikimit Strategjik dhe Kordinimit me Donatorët.

5.A.V., me detyrë specialiste në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Planifikimit Strategjik dhe Kordinimit me Donatorët.

-Prej 3 punonjësve cituar tek pikat 3, 4 dhe 5, më sipër të Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Planifikimit Strategjik dhe Kordinimit me Donatorët, nuk njihet gjendja e realizimit për secilin projekt duke mos e ndjekur, dokumentuar dhe kontrolluar, realizimin e tyre, (mungon dosja për secilin projekt dhe databezi përkatës) me arsyetimin se këto të dhëna i disponon Drejtoria e Financës.).

-Nuk kanë kryer monitorimin e projekteve dhe nuk ka përgatitur raportet vlerësuese të realizimit të objektivave të tyre.

-Nuk kanë ndërtuar një database me koordinatat dhe detaje të tjera të agjencive donatore.

-Nuk kanë përgatitur raportet vlerësuese për projektet e veçanta dhe nuk i ka shpërndahen në të gjithë partnerët.

-Nuk kanë ndjekur hapat e strategjisë së zhvillimit (monitorim, vlerësim, rishikim dhe raportim)

Veprimet apo mosveprimet e mësipërme të punonjësve të Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Planifikimit Strategjik dhe Kordinimit me Donatorët, janë në kundërshtim me Rregulloren e

Brendshme të Bashkisë Korçë, miratuar nga Këshilli Bashkiak me Vendim nr. 68, datë 20.05.2013, pika 10-Detyrat e Drejtorisë dhe konkretisht: Detyra të përgjithshme.

6. Zh.L. me detyrë Drejtore e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

-Për shkeljet e kryera në moszbatimin e nenit 9, 12 e 13, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e ndërtimeve", të ndryshuar, nenin 40, 41, 43, 44, 89, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar dhe VKM nr. 460, datë 16.06.2010 "Për organizimin dhe funksionimin e regjistrit të planifikimit të territorit".

7. E.Gj., me detyrë Përgjegjës i Sektorit për Kontrollin e Tokës dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit të shqyrtimit të ofertave të konkurrimit.

-Për shkeljet e kryera në moszbatimin e nenit 9, 12 e 13, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e ndërtimeve", të ndryshuar.

-Për shkeljet e kryera në moszbatimin e shkronjës "b" e "c", pika 7, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.

8. A.Ç. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës të regjistrit të Territorit.

-Për shkeljet e kryera në moszbatimin e Kreut V "Regjistri i Planifikimit të Territorit" të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar dhe VKM nr. 460, datë 16.06.2010 "Për organizimin dhe funksionimin e regjistrit të planifikimit të territorit". (Trajtuar në pikën 9 faqe 92-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9. K.K. me detyrë jurist në Drejtorinë Juridike.

-Për shkeljet e kryera në moszbatimin e kapitullit të II dhe pikës 1, 2 të kapitullit III, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.

10. B.M. me detyrë anëtar të Komisionit të shqyrtimit të ofertave të konkurrimit.

-Për shkeljet e kryera në moszbatimin e shkronjës "b" e "c", pika 7, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.

11. I.L. me detyrë Kryeinspektor i Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik nga data 03.05.2013 e në vazhdim.

-Për shkeljet e kryera në moszbatimin nenit 5 e 14, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", të ndryshuar, nenin 6, 13, 82, pikën 3 nenin 83, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar dhe nenin 45, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

12. A.M. me detyrë Inspektor Ndërtimor.

-Për shkeljet e kryera në moszbatimin nenit 5 e 14, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", të ndryshuar, nenin 6, 13, 82, pikën 3 të nenit 83, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar dhe nenin 45, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

13.A.D. me detyrë Drejtore e Drejtorisë Juridike.

-Për shkeljet e kryera në moszbatimin e pikës 1, 2 kapitulli III, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.

C.2-Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar dhe shkronjën (b) të nenit 9, “Kontrata individuale e punës”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Korçë, që bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore, “Vërejtje me paralajmërim” për 9, punonjësit, si më poshtë:

1. A.H. me detyrë Kryeinspektor i Policisë Bashkiake që nga data 30.06.2012 e në vazhdim,

2.Th. P. me detyrë Inspektori i Policisë Bashkiake.

Për shkeljet e mëposhtme;

-Për mos organizim të punës dhe efektivitet i ulët i strukturës së Policisë bashkiake, duke mos kërkuar dhe vendosur nga vartësit masat për dënime me gjobë në masën 500-5000 lekë,në kundërshtim me nenet 9 dhe 13 të ligjit, nr.8224, datë 15.5.1997, “Për organizimin dhe Funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”.

-Për mos vjeljen 17 gjobave në vlerën prej 33,000 lekë, në kundërshtim me nenin 14 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”,i ndrshuar,

-Për lejimin e ndërtimet pa lejë, nga ana e punonjësve të Policisë Bashkiake,në kundërshtim me kërkesat e Urdhrit të përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530 datë 07.04.2003”dhe Ministrit të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003 “Për miratimin e rregullores “TIP” të policisë bashkiake dhe të Komunës” dhe konkretisht nenin 13/6“Detyrat e punonjësve të policisë bashkiake e të komunës”.

-Për mos bashkëpunim dhe mbështetje të Drejtorisë së Taksa -Tatimeve për mosnjohjen e gjendjes debitorëve dhe mos marrjen e masave shtrënguese për pagesën e taksave, për pasojë më datën 30.04.2014 për mos shlyerje të taksave dhe tarifave vendore janë 1006 subjekte debitorë në vlerën 94,137,951 lekë.

Për mos vendosjen e gjobave në masën 500-5000 lekë, në kundërshtim me nenet 9 dhe 13 të ligjit, nr.8224, datë 15.5.1997, “Për organizimin dhe Funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, **për 4 punonjësit e policisë Bashkiake nga numri rendor 3-6, si më poshtë:**

3.H.H. për 2 vjet ka vendosur 9 gjoba në vlerën 6,000 lekë. (1gjobë-2 muaj)

4.T.C. për 2 vjet ka vendosur 5 gjoba në vlerën 7,000 lekë.(1gjobë në 3 muaj)

5.N.D. për 2 vjet ka vendosur 13 gjoba në vlerën 16,000 lekë (1 gjobë-2muaj)

6.B.H. për 2 vjet ka vendosur 18 gjoba në vlerën 31,500lekë.(1gjobë-2muaj)

Për 2 punonjësit e Drejtorise se Politikave të Zhvillimit Planifikimit Strategjik dhe Kordinimit me Donatorët, nga numri 7 deri 8, si më poshtë:

7.Xh.P. me detyrë Drejtore e Drejtorise se Politikave të Zhvillimit Planifikimit Strategjik dhe Kordinimit me Donatorët nga data 25.11.2013 e në vazhdim. (nuk ka marë detyrën me proces verbal)

8.E.I. me detyrë specialiste në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Planifikimit Strategjik dhe Kordinimit me Donatorët.

Për shkeljet e mëposhtme;

-Prej 2 punonjësve të mësipërm të Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Planifikimit Strategjik dhe Kordinimit me Donatorët, nuk njihet gjendja e realizimit për secilin projekt, duke mos e ndjekur, dokumentuar dhe kontrolluar, realizimin e tyre, (mungon dosja per secilin projekt dhe databezi përkatës) me arsyetimin se këto të dhëna i disponon Drejtoria e Financës. (*Shif listën e paraqitur nga Drejtoria e Projekteve*).

-Nuk kanë kryer monitorimin e projekteve dhe nuk ka përgatitur raportet vlerësuese të realizimit të objektivave të tyre.

-Nuk kanë ndërtuar një database me koordinatat dhe detaje të tjera të agjencive donatore.

-Nuk kanë përgatitur raportet vlerësuese për projektet e veçanta dhe nuk i ka shpërndahen në të gjithë partnerët.

-Nuk kanë ndjekur hapat e strategjisë së zhvillimit (monitorim, vlerësim, rishikim dhe raportim)

Veprimet apo mos veprimet e mësipërme të 3 punonjësve të Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Planifikimit Strategjik dhe Kordinimit me Donatorët, janë në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Korçë, miratuar nga Këshilli Bashkiak me Vendim nr. 68, datë 20.05.2013, pika 10-Detyrat e Drejtorisë dhe konkretisht: Detyra të përgjithshme.

9.T.M. me detyrë Përgjegjëse e Klubit Shumësporteve.

-Për shkeljet e kryera në moszbatimin e VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar.

D. MASA ADMINISTRATIVE:

D.1-Për Agjencinë e Prokurimit Publik

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të nenit 4 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me ndryshim VKM nr. 1195, datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëpunimin e programeve atë reklamave për transmetimin nga Operatorët Radiotelevizivë ose botim në median e shkruar dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”, VKM nr. 1173, datë 06.01.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike të pavarura”, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në proces verbalin nr.01, datë 20.06.2014, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pikës 3, kreu X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 7, pika 2,3/a, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, **i rekomandojmë Drejtorit të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet** dhe për personat përgjegjës marrjen e masave përkatëse në raport me shkeljet e konstatuara.

Nga auditimi ka rezultuar se për periudhën 01.01.2012 deri 31.12.2013 pavarësisht miratimeve në Këshillin Bashkiak, pa u zhvilluar më parë procedura prokurimi dhe pa u mbështetur në dispozitë ligjore nëpërmjet kontratave të nënshkruara nga ish-kryetari i bashkisë z.N.P., janë kryer pagesa ndaj subjekteve apo personave të tretë, në një vlerë **prej 4,924,417 lekë**, respektivisht për vitin 2012 në vlerën 3,319,700 lekë dhe vitin 2013 në vlerën prej 1,604,717 lekë, si më poshtë:

Nr	Lloji i aktivitetit	Numër Subjektesh Pronari	Viti 2012 Ne lekë	Viti 2013 Në lekë	TOTALI Lekë 2012-2013
1	Media Televizione	3	509,500	77,000	586,500
2	Media e shkruar Gazeta	3	225,000	15,000	240,000
3	Fondacione	2	2,250,000	1,450,707	3,700,707
4	Pagese për te rinjtë, Proj. YEP	5	250,000	0	250,000
5	Abonim 29 gazeta ditore	1	85,200	26,010	111,210
6	ABISNET SHA	Sherbim interneti(K.K.)		36,000	36,000
	Gjithsejtë		3,319,700	1,604,717	4,924,417

Të detajuara si më poshtë:

a.Vlera prej **826,500 lekë**, u janë paguar 3 medie televizive në vlerën 586,500 lekë dhe 3 media të shkruara në vlerën 240,000 lekë.

Pagesat e mësipërme në vlerën prej **826,500 lekë**, (509,500 + 225,000), vetëm nëpërmjet lidhjes së kontratave, midis pronarëve të medie dhe ish-kryetarit të Bashkisë Korçë N.P., janë bërë në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në VKM nr. 1195, datë 05.08.2008”Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëpunimin e programeve atë reklamave për transmetimin nga Operatorët Radiotelevizivë ose botim në median e shkruar dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore” **pasi;**

-nuk janë përzgjedhur organet e masmedias, në kundërshtim me pikën 7, të VKM të mësipërm, *ku përcaktohet se: Në vartësi të llojit të programit, reklamës apo spotit, kushtet e veçanta, për përzgjedhjen e organeve të masmedias/agjencive të specializuara janë:*

a) organi i masmedias, agjencia e specializuar (ndërkombëtar/ e kombëtar/ e, vendor.

b) çmimi i ofruar nga organi i masmedias /agjencia e specializuar.

c) koha e transmetimit.

-nuk është krijuar komision për ndjekjen e procedurave dhe hartimin e dokumenteve, në kundërshtim me pikën 8 të VKM të mësipërm ku përcaktohet se: *Komisioni për ndjekjen e procedurave dhe hartimin e dokumenteve përbëhet nga 5 antarë, 3 prej tyre specialistë të fushës.*

-nuk u është shpërndarë organeve të masmedias/agjencive të specializuara ftesë për negociata, etj., në kundërshtim me pikën 9 të VKM të mësipërm, *ku përcaktohet se: Komisioni, brenda një periudhe kohore 5-ditësh nga data e daljes së urdhrorit, u shpërndan, me korrespondencë zyrtare organeve të masmedias/agjencive të specializuara ftesën për negociata. Ftesa për negociata publikohet edhe në faqen e internetit të Institucionit.*

-në kushtet kur nuk është krijuar komisioni, nuk mund të flitet për hartimin e një raporti të hollësishëm për të gjitha procedurat e ndjekura, të cilin duhet ti paraqiste titullarit para lidhjes së kontratës, në kundërshtim me pikën 13 të VKM të mësipërm.

b.U janë paguar 2 fondacioneve nëpërmjet bankës vlera 3,700,707 lekë, respektivisht:

1. Fondacionit, K..., Mosha e trete, fëmijë rome, dhuna në familje në vlerën **2,050,540 lekë**.

2. MISIONI E... në vlerën **1,650,167 lekë**.

Në mënyrë tabelore pagesa e Fondacioneve paraqitet si më poshtë:

Nr	Subjekti	Lloji i aktivitetit	Pronari	Viti 2012 Ne lekë	Viti 2013 Në lekë	TOTALI 2012-2013
1	Fondacioni, K...	Mosha e trete, fëmijët rome, dhuna në familje	Fondacioni K...	1,250,000	800,540	2,050,540
2	MISIONI E...	Mosha e trete, fëmijët rome dhe egjiptiane	MISIONI E...	1,000,000	650,167	1,650,167
	Gjithsejt			2,250,000	1,450,707	3,700,707

Xhirimi i fondeve publike të Bashkisë Korçë, 2 Fondacioneve të mësipërme, në vlerën 3,700,707 lekë, pa zhvilluar procedura prokurimi, është në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar -**Neni 4-Fusha e zbatimit, përcaktohet se;** Ky ligj zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit publik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 5,6,7,8 e 9 të këtij ligji që rregullohen me ligj tjetër.

-Neni 5, Prokurimet për mbrojtjen kombëtare.

-Neni 6, Kontratat sekrete dhe kontratat që kërkojnë masa të veçanta sigurie,

-Neni 7, Përjashtime të veçanta a) blerjen ose qeranë të pasurive të paluajtshme, blerjen, zhvillimin, prodhimin, e reklamave, etj...c) shërbimet e arbitrazhit apo pajtimit ç) shërbimet financiare për shitjen, blerjen apo transferimin e titujve ose instrumenteve të tjera financiare, etj, d) shërbimet e kërkim zhvillimit, etj

-Neni 8, Detyrimet Ndërkombëtare, etj

-Neni 9, Kontratat e shërbimit, të shpallura fituese në bazë të drejtës ekskluzive.

-Neni 28, pika 2, "Metodat e përlogaritjes së vlerës së kontratave publike" ku parashikohet se: Nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara në këtë ligj.

-VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me ndryshime, përkatësisht; -Kreun II-të "Rregullat e Përgjithshme të Prokurimit", Pika 1 "Kufijtë monetarë", shkronja (b), në kreun VI, të këtyre rregullave, shkronja (c), ku parashikohet se: Asnjë kontratë publike nuk mund të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo procedurave të parashikuara nga ligji "Për Prokurimin Publik".

c. Në Bashkinë Korçë për lidhjen e kontratave të ndryshme me VKB dhe pa u mbështetur në dispozita ligjore me pretendimin e bashkëpunimit dhe kontributit të Bashkisë të një shume të caktuar me qëllim përfitimin e projekteve të ndryshme, nga ish- kryetari i bashkisë N.P. janë lidhur Kontratat me 2 Fondacionet, respektivisht: K... dhe Misionin E..., si më poshtë:

1-Me Fondacion K..., për projektin "Për moshën e tretë, fëmijët romë, dhuna në familje etj", këtij Fondacioni nga fondet e Bashkisë i janë xhiruar nëpërmjet bankës vlera **prej 2.050,540 lekë**.

2-Me Misionin E..., për projektin "Fuqizimin e fëmijëve romë-egjiptianë", për vitin 2012 bazuar vetëm në 2 kontratat e lidhura me ish- kryetarin e bashkisë N.P., nga fondet e bashkisë Korçë këtij Misioni i janë xhiruar nëpërmjet Bankës vlera **1,650,167 lekë**.

Në të 2 rastet e mësipërme pavarësisht se nuk është përcaktuar termi sponsorizim kalimi i fondeve në llogarinë e këtyre fondacioneve është një formë sponsorizimi, pagesë kjo në kundërshtim edhe me ligjin nr. 7892, datë 21.12.1994 "Për sponsorizimet" i ndryshuar, neni 3, ku përcaktohet se: Sponsorizues në kuptim të këtij ligji janë vetëm subjektet që kanë cilësinë e tregtarit, qofshin këta persona fizikë ose juridikë, vendas, të huaj a me kapital të përbashkët. Subjektet buxhetore ose që përfitojnë financime buxhetore, nuk mund të jenë sponsorizues.

d) Në 5 raste pa zhvilluar procedurë prokurimi u është xhiruar personave fizikë për zhvillim biznesi vlera prej 250,000 lekë.

e) Në 3 raste pa zhvilluar procedurë prokurimi vetëm bazuar në kontratën datë 01.10.2012, lidhur ndërmjet ish kryetarit të bashkisë N.P. dhe drejtorit të shitjeve, për pajtim interneti, i është xhiruar subjektit privat A... Sha, me NUIS KO1417001C, vlera **prej 36,000 lekë**.

f) Pa zhvilluar procedurë prokurimi, vetëm bazuar në kontrata dypalëshe lidhur ndërmjet ish-kryetarit të Bashkisë N.P. dhe Personit Fizik Y.C. (Kioskë) për furnizim me shtypin e përditshëm me 29 gazeta të llojeve të ndryshme për periudhën e viteve 2012-2013, i është xhiruar vlera **prej 112,000 lekë**.

d.2-. Për Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik Bashkia Korçë.

Bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", neni 15, ndryshuar me nenin 2 të ligjit nr. 9826, datë 01.11.2007, për shkelje të nenit 7; pikat, 1, 3, 4, 17, 18 dhe 19 të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar; pikat, 8, 8/1, 8/2 dhe 10 të kreut II-të dhe pikat 4, 5 të kreut III-të, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", i **propozohet**: Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor dhe Urbanistik, Vendor pranë Bashkisë Korçë, që të vlerësojë dhe të marrë masa administrative me gjobë për **2 mbikqyrës të punimeve si më poshtë**:

1. Shoqëria "T.. C..." sh.p.k, mbikëqyrës i punimeve të ndërtimit, për mos kontroll të punimeve të pakryera në 4 objekte për 17 zëra punimesh duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën **1,032,111 lekë**, të detajuara si më poshtë:

1.1-në objektin “Sistemim asfaltim, Blloku i banimit lagja nr. 17”, Korçë, sipas kontratës për punë publike lidhur me datë 16.08.2010, rezultojnë diferenca në volume pune të pa kryera në 3 zëra punimesh, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **160.200 lekë** pa t.v.sh. (Kontratë Shërbimi Mbikëqyrje lidhur me datën 16.08.2010 me vlerë 275,000 lekë)

1.2-në objektin “Sistemim asfaltim rruge ne blloqet e pallateve , lagja nr. 17/1”, sipas kontratës baze për punë publike datë 20.07.2010, (Kontratë Shërbimi Mbikëqyrje dt. 20.07.2010 me shoqërinë mbikëqyrëse “T...-C...” shpk me përfaqësues ligjor z. Ll.Ll., me vlerë shërbimi 115.000 leke.

-për kontratën baze date 20.07.2010, rezultojnë diferenca në volume pune të pa kryera dhe përfitim më tepër nga operatori ekonomik “J...C...” shpk duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit në 3 zëra punimesh në vlerën **158.980 lekë**

-për kontratën e dyte date 13.12.2011, rezultojnë diferenca në volume pune të pa kryera dhe përfitim më tepër nga operatori ekonomik “V...” shpk duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit në një zë punimesh në vlerën **120.468 lekë** (pa t.v.sh).

1.3- në objektin “Sistemim asfaltim rruge ne blloqet e pallateve lagja nr. 15”, sipas kontratës baze për punë publike datë 20.07.2010, rezultojnë diferenca në volume pune të pa kryera dhe përfitim më tepër nga operatori ekonomik “J...C...” shpk duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit në 3 zëra punimesh në vlerën **109.480 lekë**

- në objektin “Sistemim asfaltim rruge ne blloqet e pallateve lagja nr. 15”, sipas kontratës baze datë 26.11.2011, rezultojnë diferenca në volume pune të pa kryera dhe përfitim më tepër nga operatori ekonomik “V...” shpk duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit në 3 zëra punimesh në vlerën 266.333 lekë.

1.4-në objektin “Sistemim asfaltim rruge ne blloqet e pallateve,lagja nr. 15 (vazhdim)”, sipas kontratës baze për punë publike datë 20.07.2010, rezultojnë diferenca në volume pune të pa kryera dhe përfitim më tepër nga operatori ekonomik “J...C...” shpk duke shkaktuar dëm ekonomi në 3 zëra punimesh në vlerën **127.050 lekë**.

-për kontratën e dyte date 26.12.2011 lidhur me operatorin ekonomik “A...” shpk rezultojnë diferenca në volume pune të pa kryera dhe përfitim më tepër nga operatori ekonomik “A...” shpk duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit në një zë punime në vlerën 89.600 lekë.

2.V.G. me detyrë mbikëqyrëse e punimeve.

Për mos kontroll të punimeve në objektin “Rikonstrukcion i Sheshit para Katedrales”, sipas kontratës për punë publike nr. 7/11 prot, datë 21.05.2012, zbatues bashkimi i Operatorëve ekonomik “N...” sh.p.k, & “K...”. Pasi nga auditimi rezultojnë diferenca në volume pune të pa kryera në 3 zëra punimesh duke shkaktuar një dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Korçë në vlerën **329,932 lekë** pa tvsh .

Për ndjekjen e zbatimit të kontratës nga mbikëqyrësja e punimeve V... G... është lidhur Kontratë Shërbimi Mbikëqyrje nr. 7/15 prot, dt. 25.06.2012 me vlerë 449,100 lekë.

F. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR QË NUK KANË ADRESIM INSTITUCIONAL

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre, por duhet të njoftohet DAP lidhur me rekomandimin që KLSH do të kishte dhënë masë nëse do të ishin ende në marrëdhënie pune, **përkatësisht;**

1.A.K. me detyrë supervizor i punimeve, pasi ka dalë në pension pleqërie.

2.A.R. me detyrë ish-përgjegjëse e sektorit kontabilitetit, pasi ka dalë në pension pleqërie.

3.A.Q. me detyrë ish-Kryeinspektor i Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik deri me 02.05.2013.

4.I.J. me detyrë ish-Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike në Bashkinë Korçë larguar me datë 03.03.2014.

Meqenëse shkeljet e konstatuara janë pa dëm ekonomik dhe të karakterit administrativ, ku disa mangësi u riparuan gjatë periudhës së auditimit, nuk propozojmë masë ndaj 2 punonjësve të mëposhtëm;

1.V. Z. me detyrë Drejtore e Financës, për një periudhë 1.5 vjeçare, pasi për periudhën nga data 20.05.2013 deri më datën 25.11.2013, detyrën e Drejtorit të Financës e ka kryer z. Keltjon Kita.

2.T. Sh. me detyrë Specialiste e kontabilitetit.

3. Operatori ekonomik J...-C..., Elbasan, ka lidhur 3 kontrata për 3 objekte, por i ka ndërprerë ato dhe për punimet e mbetura janë vazhduar procedura të tjera prokurimi dhe lidhur kontrata me operatorë të tjerë. Ndaj Operatori ekonomik J...-C..., do kërkonim përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurime publike, bazuar në UKM nr. 01, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit publik” i ndryshuar. KREU i VIII, pika 2/a “Mbikëqyrja e Kontratës”, por përjashtimi i këtij operator ekonomik, ishte realizuar pas kërkesës nga mbikëqyrësi i punimeve.

Nga Bashkia Korçë me shkresë nr. 1615/19, prot, datë 07.10.2014, protokolluar në KLSH me nr.453/11 datë 22.10.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Niko Nako, Qemal Shehu, Vaso Peci, Jonel Nasto dhe Xhemal Luka më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT